

Emri i Lëndës : Procedurë Penale e Avancuar me Praktikë Gjyqësore							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 433	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Nertil Bërdufi, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		E drejta procedurale penale e Avancuar me Praktikë Gjyqësore është lënda mësimore që shpjegon, teorikisht dhe praktikisht legjislacionin procedural penal, institutet dhe dispozitat që rregullojnë procedimin penal në të gjitha fazat e tij. Ajo analizon shkencërisht sistemet procedurale penale, zhvillimin historik të legjislacionit procedural në Shqipëri deri në miratimin e Kodit të Ri të Procedurës Penale, si dhe parimet demokratike në të cilat bazohet procedimi penal. Analiza e percaktime të hollësishme bëhen për subjektet e procedimit penal, për vendin që zënë, rolin që luajnë dhe raportet midis tyre; për kuptimin, llojet dhe çmuarjen e provave; për kushtet dhe kriteret që duhen zbatuar në marrjen e masave të sigurimit; për detyrat e prokurorit dhe të policisë gjyqësore gjatë fazës së hetimeve paraprake; për rregullat e gjykimit në shkallë të parë; për kuptimin dhe veçoritë e gjykimit në apel dhe në kasacion; për mënyrën e ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë; për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja etj. Programi është ndërtuar në përputhje me strukturën e Kodit të Procedurës Penale dhe për leksione të caktuara parashikon seminare teorikopraktik, në të cilat diskutohen përmbajtja e lëndës, lidhur me praktikën gjyqësore.					
Objektivat		Përgatitja e juristëve të ardhshëm me njohuri të thellë në fushën e procesit penal në përputhje me standardet ndërkombëtare të vendosura për këtë qëllim, të aftë për dhënien e drejtësisë,në luftën kundër kriminalitetit,duke respektuar të drejtat e njeriut. Rritja e nivelit të formimit teorik të tyre nëpërmjet njohjes me të thelluar të mendimit të përparuar bashkëkohor për ndarjen e pushteteve,sistemet procedurale,parimet dhe institutet kryesore të procedimit penal etj. Kuptimin e drejtë të vendit që zene dhe rolit që luajnë subjektet e procedimit penal,raportet midis tyre,të drejtat dhe detyrimet që kanë dhe mënyra e realizimit te tyre në praktike. Formimit profesional e kulturor,të mbështetur në njohjen e legjislacionit dhe të praktikës gjyqësore,në etikën profesionale dhe kulturën e debatit. Fitimin e shprehive për mënyrën e hartimit të akteve procedurale ,në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullat gjuhësore e ato logjike,dukefilluar nga marrja e kallëzimit,tek vendimi gjyqësorë i formës së prerë e deri tek vënia e tij në ekzekutim. Aftësimi për të proceduar konkretisht në hetimin paraprak dhe në gjykim,nëpërmjet diskutimit dhe zgjidhjes së rasteve të praktikës gjyqësore apo të gjyqeve gjithë të aktivizohen në role të caktuara. Stimulimi i punës së pavarur shkencore gjatë pjesës teorike ashtu dhe pjesës që do të zhvillohet gjatë semestrit.					
Konceptet Kryesore							
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Kuptimi dhe rëndësia e të drejtës procedurale penale						
2	Lidhja e të drejtës procedurale penale me degët e tjera të së drejtës						
3	Parimet kryesore te procedimit penal						
4	Prokuroria						
5	I Pandehuri						

6	Juridiksioni dhe kompetencat
7	Aktet, Njoftimet dhe Afatet Çështjet
8	Provim Gjysmëfinal
9	Masat e sigurimit personal :ndalimi i daljes jashtë shtetit
10	Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale ose afariste
11	Caktimi i masave të sigurimit në rastin e arrestimit në flagrancë dhe ndalimit të të dyshuarit
12	Hetimet paraprake, çështjet
13	Ankimi i Çështjes
14	Vendimet e Gjykatave
15	Ekzekutimi i Vendimeve Penale Gjendja Gjyqësore
16	Provim Final
Parakushtet	
Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura	
• Hoxha, A., Islami.,H., Panda, I (2011).Procedura Penale . Tiranë: Morava	
Referenca të tjera	
• Hajdari,A. E Drejta Procedurale Penale • Sahiti,E. Argumentimi në Procesin Penal • Vendime Unifikuese të kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të R. SH (1999-2009)	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Në përfundim të lëndës studenti do të jetë në gjendje të ketë njohuri të thella në fushën e procesit penal në përputhje me standardet ndërkombëtare
2	Studenti do të jetë në gjendje të kuptojë rolin e subjekteve procedurale penale
3	Studenti do të gëzojë një formim profesional e kulturor,të mbështetur në njohjen e legjislacionit dhe të praktikës gjyqësore,në etikën profesionale dhe kulturën e debatit.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	10	10
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			150
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			6.00
ECTS			6.00